



<b>Programi i lëndës “Teknologji farmaceutike”</b>	
<b>Lëmi</b>	<b>Shëndetësi</b>
<b>Profili</b>	<b>Farmaci</b>
<b>Niveli</b>	<b>I</b>
<b>Klasa</b>	<b>Klasa 11</b>
<b>Fondi i orëve të lëndës:</b>	<b>35 javë x 1 orë/javë = 35 orë gjithsej</b>
<b>Programi i hollësishëm i lëndës</b>	
<b>Kapitulli I: Mikrobiologji e përgjithshme</b>	
<b>a) Qëllimet e kapitullit</b>	
Në përfundim të kapitullit nxënësit duhet të: <ul style="list-style-type: none"><li>- përkufizojnë format farmaceutike të lëngëta</li><li>- përshkruajnë klasifikimin e formave të lëngëta farmaceutike</li><li>- shpjegojnë epërsitë dhe të metat e tyre</li></ul>	
<b>b) Temat e kapitullit</b>	
<ul style="list-style-type: none"><li>- Njohuri të përgjithshme për format farmaceutike të lëngëta</li><li>- Klasifikimi i formave farmaceutike të lëngëta</li><li>- Epërsitë dhe të metat e tyre</li></ul>	
<b>c) Udhëzime didaktike për kapitullin</b>	
Rekomandohet që mësimmshënësi të: <ul style="list-style-type: none"><li>- shpjegojë në mënyrë sa më bashkohore</li><li>- të përcjellë aftësitë e të nxënësve duke punuar në grupe</li><li>- të rrisë vëmendjen e nxënësve nëpërmjet pyetjeve dhe përgjigjeve me gojë.</li><li>- kërkojë nga nxënësit të shpjegojnë dallimet në mes të tretësirave ujore, vajore dhe alkoolike.</li></ul>	
<b>d) Kushtet për realizimin e kapitullit</b>	
<ul style="list-style-type: none"><li>- Mjetet mësimore</li><li>- Video projektorë dhe CD-programe</li><li>- Mostra standarde të tretësirave</li></ul>	
<b>Kapitulli II: Format farmaceutike të buta</b>	
<b>a) Qëllimet e kapitullit</b>	
N Në përfundim të kapitullit nxënësit duhet të : <ul style="list-style-type: none"><li>- përshkruajnë format farmaceutike të buta;</li><li>- dallojnë format e buta farmaceutike</li><li>- shpjegojnë epërsitë dhe të metat e tyre</li></ul>	
<b>b) Temat e kapitullit</b>	
<ul style="list-style-type: none"><li>- Format farmaceutike të buta</li><li>- Klasifikimi i formave të buta farmaceutike në varësi të përmbajtjes së tyre</li><li>- Epërsitë dhe të metat e pomadave.</li></ul>	
<b>c) Udhëzime didaktike për kapitullin</b>	
Rekomandohet që mësimmshënësi të: <ul style="list-style-type: none"><li>- ilustrojë ligjëratat me shembuj dhe ushtrime konkrete;</li></ul>	

<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përcjellë me kujdes përparimin e nxënësve gjatë shpjegimit</li> <li>- Bëjë demonstrim me mostra</li> <li>- Nxitë aftësitë dalluese të nxënësve duke punuar në grupe</li> </ul>
<p><b>d) Kushtet për realizimin e kapitullit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Forma të buta farmaceutike sa për ilustrim</li> <li>- CD- programet, atlase,</li> <li>- materiale nga interneti, broshura</li> </ul>
<p><b>Kapitulli III: Format farmaceutike të ngurta</b></p>
<p><b>a) Qëllimet e kapitullit</b></p> <p>Në përfundim të kapitullit nxënësit duhet të :</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– Përkufizojnë format farmaceutike të ngurta</li> <li>– Dallojnë format e ngurta farmaceutike</li> <li>– Shpjegojnë epërsitë dhe të metat e tyre</li> </ul>
<p><b>b) Temat e kapitullit</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– Forma farmaceutike të ngurta.</li> <li>– Llojet e formave të ngurta farmaceutike</li> <li>– Epërsitë dhe të metat e formave farmaceutike të ngurta</li> </ul>
<p><b>c) Udhëzime didaktike për kapitullin</b></p> <p>Rekomandohet që mësuesi të:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- shpjegojë përmbajtjen e temave duke përdorur skema apo foto për të lehtësuar të kuptuarit e nxënësve;</li> <li>- ilustrujë ligjëratat me shembuj dhe ushtrime konkrete;</li> </ul>
<p><b>d) Kushtet për realizimin e kapitullit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- forma të ngurta farmaceutike për ilustrim</li> <li>-CD- programet</li> </ul>